

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-126/2013**

**Prishtinë  
15 April 2013**

Në çështjen juridike të:

**Z M**  
S  
3....  
M

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

kundër.

**T P**  
Rruga "B i D" 72 A/3  
P

***Pala përgjegjëse në kërkesë /Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00882), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 15 April 2014, mori këtë:

### AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z M kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 të datës 5 shtator 2012, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00882.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 i datës 5 shtator 2012 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00882.

#### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 qershor 2007, paraqitësi i kërkesës Z M ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së tij pronësore për banesën që ndodhet në Prishtinë në lagjen Dardania SU-9/1, Blloku II, Banesa nr. 23, me sipërfaqe prej 60.83 m<sup>2</sup> (në tekstin e mëtejshëm: Banesa).
2. Z M ka pretenduar se ai e ka humbur mundësinë për të ushtruar të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në vitet 1998/99. Ai gjithashtu kërkonte kompensim.
3. Kërkesa e paraqitur nga Z M është hedhur poshtë me Vendimin KPCC/D/R/167/2012 të datës 5 shtator 2012 (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi i KKKP-së) mbi bazën e argumentit se çështja e njëjtë ne mes të palëve të njëjta është vendosur më parë përfundimisht me një vendim për ri-shqyrtim të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës (KKPB), vendimi numër HPCC/REC/86/2006/C, i datës 11 dhjetor 2006. Kështu çështja u bë *res judicata* në mes të palëve.
4. Më 19 mars 2013, vendimi i KKKP-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me datën 28 mars 2013.
5. Më 26 prill 2013, paraqitësi i kërkesës (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuuese) kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme.
6. Më parë, e drejta pronësore dhe e ri-posedimit mbi banesën në fjalë ka qenë objekt i vendosjes nga Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore i Kosovës (KKPB). Me vendimin

HPCC/D/132/2004/A&C të datës 18 qershor 2004, Komisioni ka miratuar kërkesën e kategorisë A (nr. DS000371) e T P që tani është palë përgjegjëse në kërkesë. Kërkesa e kategorisë C (nr. DS301858) e tani palës ankuese Z M, ishte hedhur poshtë.

7. Pas kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga Z M lidhur me vendimin HPCC/REC/86/2006 të datës 11 dhjetor 2006, përsëri kërkesa e kategorisë A, DS000371 e T P ishte miratuar dhe kërkesa e kategorisë C, DS301858, e palës ankuese Z M ishte hedhur poshtë.

### **Pretendimet e palëve**

8. Pala ankuese Z M kërkon që lënda e tij të rishqyrtohet me lëshimin vendimit të drejtë dhe të ligjshëm që atij të ia mundësoj rikthimin e të drejtës së tij pronësore mbi banesën e kërkuar. Në këtë kuptim ai kërkon nga Gjykata Supreme ta shqyrtoj vendimin e KKP-së meqë çështja veç ishte vendosur me vendim të formës së prerë të KKP-së dhe se dhe se duhet të konsiderohet si *res judicata*.

9. Për të mbështetur ankesën e tij, pala ankuese Z M i referohet argumenteve të prezantuara para AKP/KKP-së. Ai i ka bashkangjitur ankesës së tij dokumentet e njëjtë të prezantuar më parë në procedurën para AKP/KKP-së.

10. Për më tepër pala ankuese Z M thekson se vendimet e KKP-së dhe më vonë të KKP-së kanë pranuar “mashttrimin” e pabesueshëm dhe në vend të marrjes së vendimit të ligjshëm, janë marrë vendime politike duke përdorur pretendimet se pala përgjegjëse në kërkesë është diskriminuar.

### **Arsyetimi ligjor**

11. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

12. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, vendimit të apeluar dhe pretendimeve të palës ankuese, gjeti se ankesa është e pabazuar.

13. Nën parimin *res judicata* është atëherë kur lënda nuk duhet të shqyrtohet nga gjykata kur çështja e njëjtë, me palët e njëjta që marrin pjesë në procedurë, tanimë është vendosur nga një

gjykatë tjetër. Kjo është situata në rastin aktual, kërkesa e njëjtë është paraqitur në KKPB-së dhe KKPK-së dhe palët pjesëmarrëse ishin të njëjtat në të dy procedurat. Gjithashtu, faktet, baza ligjore si dhe çështjet e provave janë krejtësisht të njëjta në të dy kërkesat e dorëzuara në KKPB-së, respektivisht KKPK-së.

14. KKPK me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën e Z M mbi bazën se lënda është *res judicata* në mes të palëve të njëjta. Çështja e njëjtë tashmë është gjykuar me një vendim të plotëfuqishëm, HPCC/REC/86/2006 të datës 11 dhjetor 2006, para se të dorëzohej kërkesa në fjalë. Me vendimin e sipërpërmendur, KKPB-ja e ka hedhur poshtë kërkesën e mëhershme pasi që Z M ka dështuar të dëshmoj se ai kishte ndonjë të drejtë pronësore mbi banesën në fjalë. Një vendim i tillë paraqet një vendosje përfundimtare lidhur me meritat e kërkesës. Prandaj, paraqitësit e kërkesës nuk mund t'i lejohet që kërkesa e tij e njëjtë të shqyrtohet edhe një herë për të njëjtën çështje në mes të palëve të njëjta.

15. Gjykata Supreme konsideron se vendimi i KKPK-së ka qenë i drejtë për sa i përket hedhjes poshtë të kërkesës në kuadër të kufijve të juridiksionit dhe kompetencave të KKPK-së në përputhje me nenin 11.4.c të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe i njëjti vendim duhet të konfirmohet.

16. Bazuar në atë që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 166, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

17. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotëfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**